



la Biennale di Venezia

**12. Mostra
Internazionale
di Architettura**

Partecipazioni nazionali

NGJYRAT E ARKITEKTURES

**Pavioni Shqiptar ne Bienalen e Arkitektures ne Venezia
29 Gusht-21 Nentor 2010**

Bienalja e Arkitekturës në Venecia që nga krijimi i saj, ka qenë event i rendesishëm i shkëmbimit dhe pasurimit të ideve në këtë fushë. Për herë të parë, në edicionin e 12-të të kësaj ekspozite, Shqipëria përfaqësohet me një pavion të saj.

NGJYRAT E ARKITEKTURES, është titulli i pavionit shqiptar të kuruar nga **Gjergj Bakallbashi** (komisioner/kurator), **Enida Mitro** dhe **Egest Gjinali** (asistent kuratorë).

Duke u nisur nga tema që Kazuyo Sejima ka vendosur për bienalen:

NJEREZIT TAKOHEN NE ARKITEKTURE si dhe nga kurioziteti i tyre për të hamendësuar mbi fenomenin urban më të fuqishëm në Shqipëri: **TIRANEN**, grupi i kuratorëve vendosi ta hapë pavionin për pjesëmarrës nga vende dhe fusha të tjera.

Nëpërmjet propozimeve specifike, filmit, fotografisë, intervistave, diskutimeve si dhe punëve studentore pavioni krijon një topografi që do të shërbejë si territor i të ardhmes për bashkëpunime në fushën e arkitektures dhe design-it në lidhje me Tiranën dhe kontekste të tjera.

PROJEKTET:

Projektet e ekspozuara këtu tregojnë që "Përtej Ngjyrave" është përveçse një vend dhe një mundësi konceptuale. Po përse Përtej Ngjyrave? Pse jo përtej mureve, betonit, masës, dendësive, përtej bulevardit, rrugëve plot makina, përtej se tashmës? A ekziston një vend i tillë? Ne zgjodhëm Tiranën, kryeqytetin shqiptar dhe fenomenin më të fuqishëm urban në Shqipëri për tu dhënë përgjigje pyetjeve tona. Për të qenë metodike në përgjigje pavioni është i strukturuar në seksione:

VESHTRIM DREJT NGJYRAVE

Nëpërmjet projektit të ngjyrit të fasadave Tirana ka zënë vend në rrjetin e qyteteve të reja, në Europë e tjetërkund, të cilat kërkojnë të "rikrijohen". Sic tregojnë dhe projektet e paraqitura në këto seksione, përdorimi i ngjyrave dhe motiveve nuk varet nga vendi, koha apo një qytet i caktuar. Në to vihet re se konceptet, stilet dhe mjetet e përdorura shkojnë përtej përdorimit të thjeshtë të ngjyrës.

TIRANA OFF MODERN/TIRANA ART NOUVEAU

Svetlana Boym, Profesore, Universiteti i Harvard-it

PROJEKT FASADE NE TIRANE

Helidon Gjergji, Artist, New York

BANESA PER PESHKATARET, TYRE LIBANON

Hashim Sarkis Studios, Harvard University

NEW GEOGRAPHIES, një publikim i Harvard University Press, Nr. 3

Gareth Doherty, Editor

VESHTRIM DREJT BULEVARDIT

Bulevardi i Tiranës është hapsira publike kryesore e qytetit. Dikur u shtri si një hapje në mes të një konteksti ekzistues urban. Fundi i tij i pambaruar, me stacionin e rrenuar të trenit, na fton të mendojmë “Çfarë do të ndodhe me bulevardin?”

Në veshtrimin drejt Zagrebit, se si Patkoi i tij i Gjelber (Zelena Potkova,) i planifikuar paralelisht me Ringstrasse-n në Vjenë, u përdor nga urbanistët dhe arkitektët dhe, çka është me e rëndësishmja, si u zgjat përtej kufijëve të tij origjinalë.

Në veshtrimin drejt Shtutgartit, për të parë raportin ndërmjet hapsirës së qytetit, përdorimit të saj, gradientëve të temperaturës dhe rrymave natyrore të ajrit të ftohtë, në mënyrë që të ti përgjigjemi pyetjes mbi të ardhmen e bulevardit në kontekstin e ndërlidhjes së tij me klimën dhe topografinë e Tiranës.

CASE STUDY 03 The Green Horseshoe: The Unfinished Figure pg 58-75

Project Zagreb: Transition as Condition, Strategy, Practice

Eve Blau dhe Ivan Rupnik

PUNE KERKIMORE MBI KLIMEN E TIRANES

Transsolar Klimaengineering, Munich Stuttgart New York

DUKE KERKUAR STACIONIN

Ardhja e kapitalizmit solli në Shqipëri enderra dhe paradokse. Të pasurit e një Mercedes-i në kundërshtim të përdorimit të transportit publik, mbi-investimi mbi privatën në dem të publikës, grija e betonit në vend të gjelberimit të pemëve, keto të gjitha janë fenomene që i perkasin Tiranës. Stacioni i trenit në Tiranë është vendi ku monumentalja, infrastrukturajla, publikja, informajla, natyralja dhe e lena pas dore, mbivendosen.

Në të shikojmë këto vend si sheshin e pershtatshëm për të hulumtuar potencialin e kompleksitetit të kesaj mbivendosje shumështrësash dhe të interaksionit interesant që kjo mund të prodhojë. Nëpërmjet niveleve të ndryshme në kohë dhe shkallë, projektet/idete propozojnë vizione për qytetaret e Tiranës, në një klimë ku hapsira publike po degradon.

HAPSIRA POETIKE

Egest Gjinali, Arkitekt, Gjenevë

Zeinab Aghamahdi, Arkitekthe, Gjenevë

TIRANA LOKALE - SHPERNDARJA E KULTURES SHQIPTARE MBI SHINA

GAC General Architecture / Collaborative :

Michael Beaman, Zaneta Hong, James Setzler, Yutaka Sho, Sunmin Whang, Jessica Yin

TIRANA TRANSECT

OFICINAA: Alexander C. Häusler and Silvia Benedetto

TIRANA: DUKE MBUSHUR HAPSIRAT BOSH

Edgar Sarli and Tamar Loeb, Miami/Basel

GJENEALOGJIA E NJE AKSIDENTI

Nuno Jacinto, Arkitekt, Portugali

VESHTRIM DREJT FASADAVE

Projektet nga 51N4E dhe Virginia Studio janë zjedhur të për treguar shkallen e arkitektures bashkekohore në Tiranë. Secili projekt ndodhet në zonë të dallueshme në Tiranë. Secili në të përgjigjet një plani të ndryshëm rregullues, kushteve të ndryshme urbane dhe kërkesave programatore të ndryshme. Të dy përdorin gjeje formale dhe strategji veshje për të krijuar një pike përqendrimi për kushtet urbane të copetuara në të cilat gjenden.

TID TOWER, Sheshi i Sulejman Pashes

51N4E: Johan Anrys, Peter Swinnen, Brussels

TANGENT

Virginia Studio: Ark. Spiro Bakallbashi, Ark. Ihsan Prushi, Ark. Renato Konomi, Tirana

VESHTRIM DREJT HAPSIRAVE

Sapo dalim nga rruget kryesore te Tiranës dhe bulevardit te saj, ndeshim hapsira qe ne pamje te pare duken shume kaotike. Shtresa te ndryshme te historise, shkalle te ndryshme, aktivitete dhe forma te ndryshme, bashkejetojne pa ndonje pretendim te vecante mbi rregullin apo format e vendosura. Projektet analitike dhe filmi i shkurter jane perpjekje per ti kuptuar keto hapsira dhe karakterin e tyre aksidental.

Propozimet e studenteve tregojne potencialin e hapsirave te tilla dhe forcen qe kane ato per te frymezuar nje varietet te tere projektesh.

SHESHI I KINOSTUDIOS

Armand Vokshi, AVATELIER, Tirana me FIN (Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit)
dhe Universiteti POLIS

EXTRA&SMALL ARCHITECTURE

Eled Fagu, Arkitekt, Tirane

VESHTRIM DREJT TRASHGIMISE

Me kontribute nga Luciano Bojaxhi dhe Irida Hasa, Instituti i Monumeteve te Kultures, Kisha Ortodokse Shqiptare, Mozaiku i Tiranës, i prezantuar gjithashtu ne seksionin "Veshtrim drejt Hapsirave" te pavionit, eshte nje rikujtim i shkelqyer i trashegimise kulturore te Shqiperise dhe te pranise se saj ne kushte urbane aktive. Se bashku me imazhe te tjera te arkitektures civile dhe fetare si dhe te strukturave ushtarake "Veshtrim drejt Trashegimise" eshte nje perpjekje e vetedijshme per te theksuar vlerat e trashegimise arkitekture. Luciano Bojaxhiu, Instituti i Monumenteve te Kultures, Tirane

UNDP-UNESCO Joint Programme, Culture and Heritage for Social and Economic Development

RRUGET E TIRANES - ese fotografike

Dritan Zajmi, Artist, Gjeneve

Fotomontazhet e Dritan Zamit terheqin vemendjen tone drejt menyres se si ndertesat kornizojne qiellin dhe krijojne konfigurimin e tij. Cdo forme qiellore eshte e vecante dhe identifikon nje vend te caktuar. Te pazakonta ne menyren se si jane kornizuar keto fotografi terheqin vemendjen drejt qiellit dhe kufizimit te tij nga arkitektura aktuale e Tiranës.

CARTE BLANCHE* - film i shkurter

Enida Mitro, Arkitekthe, Vjene/Tirane

Dritan Mesareja, Artist, Tirane

I pare nepermjet syve te nje arkitekti dhe nje artisti, ky eshte nje interpretim artistik i fenomeneve qe ndeshen ne Tirane. Nje udhetim qe eksploron topografine urbane te qytetit, ne kerkim te asaj qe perben identitetin.

* Nje leje e pa kufizuar per te vepruar dhe marre vendime